



## AKT THEMELIMI

2390  
01.04.08

### I SHOQERISE ANONIME

#### "KESH SECURITY" SHRSF SH.A.

Sot me datë 01/04/2008, në Tiranë, në mbështetje të ligjit Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", ligjit Nr.9751 datë 07.06.2007 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare", të ndryshuar dhe të ligjit Nr.8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike", u hartua ky akt themelimi nga z.Gjergj BOJAXHI, Drejtor i Përgjithshëm i KESH sh.a., si përfaqësues i Aksionerit të Vetëm, KESH sh.a., si më poshtë vijon:

#### Neni 1 Themelimi dhe Emri i Shoqërisë

Krijohet shoqëria anonime "KESH SECURITY" SHRSF SH.A. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe me Aktin e Themelimit e Statutin e saj.

Shoqëria e ka selinë e saj në Bllokun "Vasil Shanto", Tiranë, Shqipëri dhe mund të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri Anonime pa Oferte Publike.

#### Neni 2 Objekti i Shoqërisë

Objekti kryesor i shoqërisë është:

1. Sigurimi dhe ruajtja e objekteve në pronësi të sh.a. KESH-it
2. Sigurimi dhe mbrojtja e jetës dhe të shëndetit të shtetasve, vendas apo të huaj

Shoqëria ushtron veprimtarinë për kategorinë a+b sipas përcaktimeve të ligjit Nr.8770 datë 19.04.2001 "Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike" dhe si e tillë mund të shtrijë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të kryejë çdo veprim me qëllim marrjen e lejeve, autorizimeve, licensave dhe miratimeve të nevojshme për realizimin e veprimtarive të saj për të cilat kërkohen këto dokumenta administrative.

Objekti i shoqërisë mund të ndryshojë në kuptimin e zgjerimit apo ngushtimit të atij ekzistues, me vendim të asamblesë së aksionerëve duke ruajtur në momentin konkret përshatjen me dispozitat ligjore në fuqi.

#### Neni 3 Kohezzgjatja

Kohezzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat të caktuar.

1

#### Neni 4 Kapitali Themeltar dhe Aksionet

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 4'000'000 (kater milion) leke dhe ai është ndare në 4'000 (katermijë) aksione me vlerë nominale 1'000 (njemijë) leke për çdo aksion. I gjithë kapitali themeltar paguhet dhe nënshkruhet nga aksioneri i vetëm, sh.a. KESH.
2. Aksionet janë nominale dhe lirisht të transferueshme sipas ligjit shqiptar në fuqi.
  - a. Aksionari përgjigjet për humbjet e shoqërisë ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në kapitalin e shoqërisë.
  - b. Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo të zvogëlohet, në mënyrën dhe formën e parashkuar me ligj.

#### Neni 5 Ushtrimi financiar i Shoqërisë

Viti financiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor të çdo viti.

Përfundimisht, viti i parë financiar fillon në ditën e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2008.

#### Neni 6 Organet drejtuese

Organet drejtuese të Shoqërisë "KESH SECURITY" SHRSF SH.A. janë:

1. Këshilli Mbikqyres
2. Drejtori i Përgjithshëm.

#### Neni 7 Perberja e Këshillit Mbikqyres

Anëtarë të parë të Këshillit Mbikqyres të shoqërisë janë:

1. Elona Hasamataj
2. Misela Dervishi
3. Kostandin Kazanxhi

#### Neni 8

Shoqëria administrohet nga Drejtori i Përgjithshëm i cili zgjidhet nga Këshilli Mbikqyres në mbledhjen e tij të parë.

Drejtori i parë i shoqërisë është Z. Sabri Lani

#### Neni 9 Drejtuesi teknik

Drejtimi, bashkërendimi dhe kontrolli i shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike të shoqërisë do të bëhet nga drejtuesi teknik i shoqërisë i cili emërohet nga Asambleja e Aksionerëve.

Drejtuesi i parë teknik i shoqërisë është Z. Bedri Dani

2

#### Neni 10 Ekspertet Kontabel të autorizuar

Auditimi i Shoqërisë do të bëhet nga ekspertet kontabel të autorizuar të emëruar nga Asambleja e Aksionerëve.

Ekspertet e parë kontabel të autorizuar të Shoqërisë janë:

1. Irena Pulo
2. Diana Golemi

Ky Akt i Themelimit të Shoqërisë Anonime përpilohet në 5 (pese) kopje në gjuhën shqipe.

AKSIONERI THEMELUES

Drejtori i Përgjithshëm

Gjergj BOJAXHI



3